REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË PËR ARSIMIN, SPORTIN DHE RININË

Nr. 6356/1 Prot. Tiranë, më 25.11.2020

Lënda: Dërgohet draft-udhëzues për mendim

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
Adresa: Rruga e "Durrësit", Nr. 219, Tiranë

KONFERENCËS SË REKTORËVE

Ministria përgjegjëse për arsimin, në përmbushje të detyrave të saj funksionale, të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, që konsistojnë edhe në hartimin e politikave në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, konstatoi mundësinë e rishikimit të akteve nënligjore specifike në fuqi, në funksion të qartësisë së saj lidhur me procesin e aplikimit për hapjen/riorganizimin e studimeve të doktoratës.

Me qëllim përmirësimin e këtij kuadri ligjor, për programet e ciklit të tretë, studimet e doktoratës Ministria përgjegjëse për arsimin, ka hartuar një draft-udhëzues, mbi parashikimin e kritereve, dokumentacionit të nevojshëm dhe procedurën që duhet të ndiqet mbi aplikimin për hapjen e studimeve të doktoratës, të cilat paraqesin interes të veçantë për institucionet e arsimit të lartë.

Për sa më lart, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë mirëpret rekomandimet dhe sugjerimet tuaja mbi draft-udhëzuesin "*Mbi aplikimin për hapjen/riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore "Doktor"*", të cilin e gjeni bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar,

MINISTRI

EVIS KUSHI

Konceptoi:	V. Koçi B. Biçoku
Miratoi:	E. Tola
Konfirmoi:	A. Kushi

UDHËZUES

MBI APLIKIMIN PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE

"DOKTOR"

NËNTOR 2020

HYRJE

Në mbështetje të ligjit 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, studimet e doktoratës i përkasin ciklit të tretë të studimeve të larta.

Në bazë të pikës 1, të nenit 77 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", cikli i tretë i studimeve përfshin programet e studimeve "Master ekzekutiv", programet e studimeve specializuese afatgjata, si dhe studimet e doktoratës.

Në nenin 79 të ligjit përcaktohet se institucionet e arsimit të lartë, që ofrojnë studime të doktoratës, duhet të hartojnë projekte kërkimore-shkencore dhe zhvillimi për këto studime.

Gjithashtu, ligji parashikon se studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor".

Studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.

Numri i studentëve doktorantë përcaktohet nga njësia bazë dhe projekti kërkimor i çdo doktoranti përcaktohet në varësi të projekteve kërkimore të kësaj të fundit.

Në pikën 2.12 të vendimit nr. 41/2018 të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, përcaktohet se :

"Studimet e doktoratës zhvillohen pranë njësisë bazë, si pjesë e projektit kërkimor-shkencor të aprovuar dhe me financim të siguruar nga IAL-ja. Pas licencimit të programit të studimeve të doktoratës dhe certifikimit të kuotave, studentët e pranuar mund të përfitojnë nga financimi i siguruar nga IAL-ja, financim nga subjekte të tjera apo të vetëfinancohen. Njësia bazë mund të ofrojë më shumë se një projekt kërkimor për fushën e kërkimit që mbulon".

Fushat kryesore të kërkimit shkencor dhe nënfushat, propozohen nga IAL-ja mbi bazën e misionit të IAL-së dhe fushës specifike shkencore të njësive kryesore dhe njësive bazë të përfshira në propozimin e programit.

Për IAL-të me veprimtari akademike specifike në fushën me veprimtari në fushën e arteve, sporteve, rendit dhe mbrojtjes, fushat kryesore dhe nënfushat e kërkimit shkencor propozohen nga IAL-ja mbi bazën e statuseve të veçanta të IAL-ve dhe fushës specifike shkencore të njësive kryesore dhe njësive bazë të përfshira në propozimin e programit.

Ndërsa udhëzimi Nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, përcakton dokumentacionet, afatet dhe procedurat për aplikim për hapjen apo riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore "Doktor".

Referuar modeleve evropiane dhe hapave të ndërmarrë në kuadër të procesit të Bolonjës dhe reformave të ndërmarra në arsimin e lartë, studimet e doktoratës janë organizuar si programe individuale kërkimore me qëllim kualifikimin e studentëve në bazë të një projekti shkencor koherent, që synon përgatitjen e tyre shkencore dhe profesionale nëpërmjet punës kërkimore shkencore.

Referuar zhvillimeve bashkëkohore, kuadri ligjor i mësipërm artikuloi një model të ri në mënyrën e ofrimit të studimeve të doktoratës, me pikësynim arritjen e standardeve dhe eksperiencave më të mira të vendeve evropiane. Në vijim, për të lehtësuar zbatimin e modelit të ri dhe bazuar në nevojat e shprehura nga vetë institucionet e arsimit të lartë dhe studentët, për sa më sipër hartohet ky udhëzues për mënyrën, dokumentacionin dhe hapat që duhet të ndiqen nga të gjitha strukturat akademike dhe administrative, si dhe nga të gjitha IAL-të që ofrojnë studimet e doktoratës, MASR, ASCAL dhe strukturat e tjera të varësisë për aplikim për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore "Doktor", të konceptuar në dy faza kryesore.

FAZA I

Aplikimi për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore "Doktor".

1. Aplikimi në raundin e parë

IAL-ja ngarkon *në platformën e-Albania* aplikimin, *sipas formularit përkatës në platformën e-Albania*, për hapjen/re programeve të studimit, brenda afatit të përcaktuar nga MASR, për vitin akademik pasardhës.

MASR-ja, brenda një afati 60-ditor nga data e aplikimit, vlerëson formularin e aplikimit mbi informacionin e paraqitur dhe njofton subjektin në formë elektronike për vlerësimin e aplikimit.

Formulari i aplikimit përmban informacionin sipas shtojcës përkatëse, bashkëlidhur.

Në rast vlerësimi pozitiv nga MASR, procedura vijon në raundin e dytë. IAL-ja, brenda 15 ditëve, ngarkon elektronikisht dokumentacionin e mëposhtëm:

2. Aplikimi në raundin e dytë

Në rast vlerësimi pozitiv nga MASR, IAL-ja, brenda 15 ditëve, ngarkon elektronikisht dokumentacionin në platformën e-Albania sipas formularit, si vijojnë:

1. Propozimi i njësisë bazë ku do të ofrohet programi i studimit.
2. Vendimi i Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miraton hapjen e programit/eve të studimit. Në rast se propozimi vjen nga një institucion publik i arsimit të lartë dhe kërkon financim nga buxheti i shtetit depozitohet miratimi paraprak i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL). Në rast financimi nga vet IAL-ja, në vendimin e Bordit të Administrimit të IAL-së duhet të jetë e shprehur qartësisht që masa e financimit të plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit do të mbulohet nga të ardhurat e IAL-së dhe nuk do të kërkohet financim shtesë nga buxheti i shtetit (për IAL-të publike).
3. Mandatpagesa për tarifën që paguhet për vlerësimin paraprak nga ekspertët e jashtëm te caktuar sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 109/2017, të ndryshuar.
4. Akti i grupimit të njësive bazë në institucionin e arsimit të lartë, nëse është e nevojshme të grupohen, sipas fushave e nënfushave të përcaktuara në propozimin e programit.
5. Deklarim për kapacitetet infrastrukturore, si vijon:
   a) Lista e laboratorëve shkencorë të akredituar ose jo;
   b) Lista e bibliotekave të profilizuara dhe kapaciteti fizik i tyre, i shprehur në vende/poste pune-kërkimi;
   c) Lista e arkivave dhe e koleksioneve shkencore;
   d) Lista e abonimeve në revista apo e botimeve shkencore periodike, përshirë dhe ato elektronike.
6. Deklarim për impaktin e veprimtarisë kërkimore-shkencore:
   a) Lista e patentave apo e shpikjeve të regjistruara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale apo autoriteteve të huaja;
   b) Lista e projekteve kërkimore-shkencore të fituara nga programet kombëtare ose ndërkombëtare për kërkim shkencor, si koordinator projekti ose si partner në projekt;
   c) Lista e të kontratave të shërbimit sipas objektit studimor dhe e sipërmarrjeve të reja, të krijuara si rezultat i punës kërkimore-shkencore të njësisë bazë të institucioneve të arsimit të lartë.

7. Deklarim për kapacitetet akademike, si vijon:
   a) Lista e personelit akademik të njësisë bazë, apo grupimit të njësive sipas fushave i kategorisë "Profesor", me kohë të plotë, në momentin paraqitjes së kërkesës.
   b) Lista e konferencave, referimeve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, të organizuara nga personeli i njësisë bazë apo grupimit të njësive sipas fushave.
   c) Lista e personelit akademik të njësisë bazë apo grupimit të njësive sipas fushave, anëtarë në komitetet ose bordet shkencore të revistave shkencore periodike në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës apo kombëtare.

8. Deklarim mbi kriterin e ndërkombëtarizimit, si vijojnë:
   a) Lista e studimeve dhe e kërkimeve lëndore ose ndërdisiplinore të aplikuara me partner të vendeve të OECD-së dhe BE-së/të tjerë.

b) Lista e personelit akademik të njësisë bazë apo grupimit të njësive sipas fushave, të angazhuar në institucionet e arsimit të lartë të vendeve të OECD-së dhe BE-së, e matur person/në javë.
c) Lista e personelit të huaj akademik të njësisë bazë apo grupimit të njësive sipas fushave nga vendet e OECD-së dhe BE-së, të ftuar pranë njësisë bazë, e matur person/në javë.

9. Dokumentacioni mbi programin e studimit, të plotësuar në të gjitha elementet e tij, në zbatim të vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, është si më poshtë:

   a) rregullore e programit të studimeve të doktoratës;
   b) plani i studimeve të doktoratës bazuar në projektin kërkimor-shkencor. [1]

10. Në rast bashkëpunimi me një institucion tjetër vendës ose të huaj të arsimit të lartë për hapjen e programeve të përbashkëta të studimit, së bashku me dokumentacionin e mësipërm, kërkohet depozitimi në gjuhë shqipe, i përkthyer dhe njehsuar me origjinalin të dokumenteve si më poshtë:

    a) akti i akreditimit të institucionit partner;

    b) dokumenti zyrtar i bashkëpunimit (marrëveshje kuadër), ku parashikohet ofrimi i programeve të përbashkëta të studimit;

    c) marrëveshja specifike për programin konkret të studimit, ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij.

    d) lloji dhe modeli i diplomës i miratuar nga IAL-të.

3. Shqyrtimi i aplikimit

Procedura për shqyrtimin e dokumentacionit për hapjen/ e programeve të studimit:

a) shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të mësipërm realizohet në MASR, brenda 21 ditëve nga depozitimi. Në rastet kur dokumentacioni është i paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, MASR-ja i kërkon zyrtarisht IAL-së që të bëjë plotësimin/saktësimin e dokumentacionit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Në mungesë të plotësimit të dokumentacionit brenda këtij afati, konsiderohet se subjekti ka hequr dorë në heshtje nga aplikimi dhe praktika arkivohet;

b) në rast se dokumentacioni konsiderohet i plotë, dokumentacioni i kalon për vlerësim ekspertëve të caktuar nga MASR-ja, sipas fushave të ekspertizës dhe të zgjedhur nga lista vjetore e ekspertëve të miratuar nga ASCAL-ja, të caktuar me urdhër të ministrit. Ekspertët, brenda 21 ditëve, dorëzojnë raportin e vlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni vlerësohet nga ekspertët se është i

[1] Formulimi i germës "b" të pikës 9 do të reflektohet në ndryshimin e vendimit nr. 41/2018 të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar.

paplotë apo konstatohen mangësi/pasaktësi, institucionit i kërkohet zyrtarisht plotësimi i tij brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit. Në mungesë të plotësimit të dokumentacionit, brenda këtij afati, konsiderohet se subjekti ka hequr dorë në heshtje nga aplikimi dhe praktika arkivohet;

c) dokumentacioni i plotësuar i kalon për rivlerësim ekspertëve, të cilët, brenda 15 ditëve, dorëzojnë raportin e rivlerësimit në MASR. Në rastet kur dokumentacioni është përsëri i paplotë, praktika arkivohet;

d) pas vlerësimit përfundimtar pozitiv nga ekspertët, ministri miraton me urdhër hapjen e programit të studimit.

4. Akti i miratimit të programit të studimit

Në urdhrin e Ministrit për hapjen/ e programeve të studimeve të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore "Doktor", përcaktohet:

Përcaktimi i fushës kryesore të kërkimit shkencor dhe nënfushave, gjuha e programit, njësia bazë apo grupimi i njësive sipas fushave, njësia kryesore, emërtimi i IAL-së, lloji i diplomës që lëshohet, niveli sipas KSHK-së, detyrimi për akreditimin e programit, detyrimi i IAL-së për paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionit për miratimin e kuotave për këtë program mbi bazën e projekteve kërkimore shkencore të financuara, pranimi i studentëve vetëm pas miratimit zyrtar të kuotave nga MASR, detyrimin për kontrollin e ligjshmërisë nga MASR, detyrimin e IAL-së për regjistrimin e formës së diplomës në QSHA, etj.

FAZA II

Aplikimi për miratimin e kuotave të pranimit në programin e studimit të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore "Doktor".

1. Përmbledhje argumentuese

IAL-të, hartojnë projektet kërkimore-shkencore dhe të zhvillimit mbi bazën e misionit të vetë institucionit dhe interesave strategjikë të zhvillimit të kërkimit shkencor, si dhe në përputhje me fushat e tyre të ekspertizës, kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore pritëse, vit pas viti, duke përcaktuar dhe numrin e kuotave në dispozicion për atë vit akademik dhe specifikuar llojin e kuotave (me financim nga vetë njësia bazë/njësia kryesore/institucioni, me vetëfinancim nga kandidati apo me financim nga palë të treta vendase apo ndërkombëtare).

Dokumentacioni shoqërohet me një relacion mbi efektet financiare për IAL-në, arsyetimin mbi kontributin dhe përcaktimin e numri të kuotave të studimeve të doktoratës, si dhe një relacion mbi mungesën e konfliktit të interesit të miratuar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.

Pas miratimit nga IAL-të të numrit real të kuotave, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi (numri i doktorantëve përcaktohet sipas numrit dhe titujve të personelit akademik të angazhuar në programin respektiv të studimeve të doktoratës dhe projektit kërkimor shkencor), llojin e tyre, kapacitetet pritëse për atë vit akademik, i dërgohen MASR-së, e cila kryen verifikimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore pritëse, konform përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

Kuotat e doktorantëve për çdo vit akademik përditësohen në përputhje me ecurinë e projekteve kërkimore-shkencore, por gjithnjë në respektim të kornizës ligjore në fuqi.

Pas shpalljes së rezultateve të verifikimit nga MASR, të cilat certifikojnë përmbushjen e kritereve të IAL-së në lidhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore pritëse, institucioni shpall kuotat e pranimit të kandidatëve përftimin e gradës shkencore "Doktor" duke bërë transparente kriteret e pranimit, gjuhën e studimeve, vendin ku parashikohet të kryhen studimet, llojin e kuotave (me financim nga institucioni, vetëfinancim apo financim nga palë të treta), dhe projektin kërkimor. Kriteret e pranimit bëhen publike nga IAL-ja dhe i përcillen QSHA-së, së bashku me numrin e kuotave të certifikuara nga MASR.

2. Aplikimi

Pas hyrjes në fuqi të aktit të hapjes/ të programit të studimit të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore "Doktor", IAL-ja aplikon 3 muaj kalendarik përpara fillimit të vitit akademik përkatës për pranimin e kandidatëve, për miratimin e kuotave në programin përkatës të miratuar nga MASR.

IAL-ja për miratimin e kuotave të kërkuara, paraqet në MASR dokumentacioni si vijon:

A. Projekti kërkimor-shkencor, përmban 7,000 deri në 10,000 fjalë, si dhe bazohet mbi literaturë konkrete. Në projektin kërkimor shkencor përfshihet lista me referenca/bibliografi, e cila nuk është pjesë e fjalëve të kërkuara të projektit. Projekti kërkimor shkencor duhet të përmbajë:

1. Titulli

Titulli i projektit duhet të jetë i qartë, i saktë dhe konçiz. Titulli duhet të tregojë përmbajtjen dhe fokusin e projektit kërkimor-shkencor.

2. Abstrakti i projektit

Abstrakti duhet të jetë një përmbledhje i cili përmban arsyetimin e projektit, objektivat kryesore, metodat kryesore të kërkimit të përdorura si dhe rezultatet e pritshme nga projekti.

3. Situata aktuale e fushës specifike të kërkimit, konteksti dhe arsyetimi për projektin

Në këtë seksion përshkruhet gjendja aktuale e kërkimit shkencor në IAL dhe njësinë bazë, në fushë dhe nënfushën duke iu referuar literaturës ekzistuese, kërkimeve në këtë në fushë dhe nënfushë, arritjeve të deritanishme dhe nevojat që ekzistojnë për ta çuar më tej kërkimin në këtë në fushë dhe nënfushë.

4. Qëllimet dhe objektivat

Në këtë seksion të përcaktohen:

-Qëllimi i projektit kërkimor shkencor
-Objektivat e përgjithshëm të kërkimit
-Objektivat specifikë të kërkimit
-Rezultatet e pritshme

5. Çështjet/ hipotezat/ pyetjet kërkimore

Në këtë seksion parashtrohen çështjet hipotezat/ pyetjet kërkimore të projektit, sipas të cilave do të angazhohen doktorantët potencialë dhe puna e tyre kërkimore.

6. Metodat kërkimore

Qëllimi i këtij seksioni është të përshkruaj metodat dhe instrumentet që do të ndiqen dhe do të zbatohen nga kërkuesi për të arritur qëllimet dhe objektivat kërkimorë.

7. Çështje etike

Në këtë seksion të përcaktohen mënyrat e respektimit të etikës së kërkimit, sipas akteve të brendshme të IAL-së. (Kodi i Etikës së Kërkimit)

8. Planifikimi kohor

Në këtë seksion duhet të përcaktohen plani i veprimit për përshkrimin e aktiviteteve dhe afati për plotësimin e detyrimeve të doktorantëve që do të jenë pjesë e projektit kërkimor shkencor.

9. Produktet kërkimore

Produktet kërkimore nënkupton identifikimin e produkteve (outputeve) kërkimore që do të materializohen në fund të projektit dhe që do të kenë një impakt tek institucioni, bota akademike dhe shoqëria. Përfshin tërësinë e produkteve të projektit kërkimor dhe vlen për të vlerësuar dobinë e projektit kërkimor shkencor të propozuar.

10. Përfituesit

Në këtë seksion identifikohen përfituesit e drejtpërdrejtë të projektit kërkimor dhe përfituesit e tërthortë, të produktit kërkimor.

11. Analiza e riskut

Analiza e riskut nënkupton marrjen parasysh të disa elementëve si: koha, menaxhimi i projektit, burimet e kufizuara, teknologjia, etj. të cilët mund të shkaktojnë mos realizimin e projektit.

Në këtë seksion duhet përcaktuar:

- Çfarë impakti mund të kenë vonesa të caktuara mbi realizimin e projektit?
- Si do të menaxhohen risqet e identifikuara?
- Cilat risqe mund të bllokojnë/ngadalësojnë projektin? etj.

12. Burimet njerëzore, infrastrukturore dhe kosto e projektit

Specifikohen zërat e buxhetit për realizimin e projektit kërkimor shkencor.

13. Diseminimi i rezultateve të projektit kërkimor

Ky seksion duhet të paraqesë mënyrën sesi do të diseminohen për komunitetin shkencor e më gjerë, rezultat e arritura nga projekti kërkimor shkencor.

14. Shtojcat

- Numri i personelit akademik i kategorisë "Profesor", i cili do të shërbejë si udhëheqës.
- Përcaktimi i kuotave të studentëve doktorantë.

B. Vendimi i Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miraton numrin e kuotave të doktorantëve dhe projektin kërkimor-shkencor, sipas propozimit të njësisë bazë.

C. Kriteret e pranimit në studimet e doktoratës të miratuara me vendim të Senatit Akademik sipas propozimit të njësisë bazë.

D. Tarifa për studimet e doktoratës të miratuara nga Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik.

E. Relacion për efektet financiare të miratuar nga Bordi i Administrimit i IAL-së.

F. Lista e plotë emërore e personelit akademik për numrin e kuotave të doktorantëve dhe projektin kërkimor-shkencor. Dosja e personelit përmban:

i. kontratat e punës me personelin akademik të kategorisë "Profesor" me kohë të plotë;
ii. dëshmitë që vërtetojnë gradat shkencore dhe titujt akademikë;
iii. në rastin e hapjes së një programi studimi në gjuhë të huaj, personeli akademik duhet të ketë fituar së paku një diplomë të një programi studimi në një nga ciklet e studimeve universitare të kryer në gjuhën në të cilën do të zhvillohet programi i studimit ose të zotërojë dëshmi për nivelin C1 të njohjes së gjuhës respektive në të cilën do të ofrohet programi, vërtetuar përmes testeve ndërkombëtare, të cilat ndodhen në listën e miratuar nga MASR-ja për pranimet në ciklin e dytë dhe të tretë.

G. Informacion mbi kapacitetet infrastrukturore dhe akademike që zotëron njësia bazë ose grupimi i njësive bazë sipas fushave të kërkimit, në dispozicion të grupimit përkatës të personelit akademik dhe numrit të doktorantëve, në përputhje me projektin kërkimor shkencor të paraqitur.

3. Shqyrtimi i dokumentacionit dhe kërkesës për miratimin e kuotave.

MASR shqyrton dokumentacionin për miratimin e kuotave e kuotave mbi bazën e projektit kërkimor-shkencor të miratuar dhe financuar, i cili duhet të jetë i lidhur me fushën dhe nënfushën e kërkimit shkencor që është hapur programi i studimit të ciklit të tretë për fitimin e gradës shkencore "Doktor", kapaciteteve infrastrukturore të vënë na dispozicion të projektit dhe kapaciteteve të personelit akademik të përfshira në projektin përkatës.

MASR në mbështetje të përcaktimeve të këtij udhëzuesi, miraton plotësisht apo pjesërisht numrin e kuotave për projektin kërkimor shkencor dhe të zhvillimit ose refuzimin e tyre.

MASR shqyrton kërkesën brenda 30 ditëve dhe nxjerr aktin e miratimit apo refuzimit të kuotave.

4. Akti i miratimit të kuotave

Në aktin e Ministrit për miratimin e kuotave, përcaktohet:

Emërtimi i fushës dhe nënfushës së kërkimit shkencor, projekti kërkimor-shkencor, njësia bazë apo grupimi i njësive sipas fushave për studimet e doktoratës, njësia kryesore, emërtimi i IAL-së, viti akademik për fillimin e studimeve, afati për realizimin e projektit dhe kohëzgjatja normale e studimeve sipas numrit të kuotave të miratuara nga MASR, gjuha e studimeve etj.

FAZA III

MATRIKULLIMI

Në përfundim të procesit të përzgjedhjes së studentëve doktorantë, IAL dërgon në QSHA listën e kandidatëve fitues të doktoratës, në rrugë zyrtare, për regjistrimin e tyre dhe dhënien e numrit të matrikullimit, jo më vonë se data e fillimit të vitit akademik.

QSHA verifikon numrin e kuotave të miratuara nga ministria dhe kriteret e pranimit të miratuara nga IAL-ja dhe pajis studentët me numër matrikullimi, sipas kërkesës së IAL-së.

FAZA IV

AKREDITIMI DHE REGJISTRIMI I FORMËS SË DIPLOMËS

IAL, përpara lëshimit të diplomave të para, duhet të jetë i akredituar institucionalisht dhe për studimet e doktoratës për të cilin lëshohet diploma, konform kuadrit ligjor në fuqi, si dhe të ketë regjistruar formën e diplomës sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

PROJEKT-PROPOZIMI PËR HAPJE TË PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"

1. Institucioni /IAL	2. Aplikimi (zgjidh një): Program i ri _____ Riorganizim programi _____
3. Emërtimi i programit të propozuar për hapje/riorganizim **Fusha kryesore e kërkimit :**_____ **Nënfusha e kërkimit/ shkenca**: Doktoratë në "_____"	
4. Viti akademik i hapjes, pas miratimit të numrit të kuotave ____	
5. Të dhënat për aktin e hapjes/ akreditimit të IAL dhe/ ose njësisë kryesore që ofron programin e studimit	6. Vendimi i miratimit nga Senati Akademik Nr._____, datë _____ Vendimi i miratimit nga Bordi i Administrimit Nr_____, datë _____
7. Nëse është një program i përbashkët, cito aktin e bashkëpunimit ndërmjet IAL-ve dhe marrëveshjen specifike për realizimin e studimeve të doktoratës.	
8. Organizimi i Programit: - **Programi ofrohet nga një njësi bazë:** Njësia bazë _____ Njësia Kryesore _____ Kampusi/ godina _____ - **Program i përbashkët i ofruar nga disa njësi bazë:** Njësia/Njësit bazë _____ Njësia Kryesore _____ Kampusi/ godina _____	

9. Të dhënat për Koordinatorin e Doktoratës: 1. **Emër, Mbiemër:** **Pozicioni në IAL:** **Tel:** **E-mail:**
10. Deklaratë e titullarit të IAL për plotësimin e standardeve akademike dhe infrastrukturore, të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
11. Firma (emër, mbiemër) e titullarit të institucionit dhe vula e institucionit. **REKTORI** **Prof. Dr. _____** **Data _____** **Firma, vula**

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT PËR HAPJE/RIORGANIZIM

Institucioni i arsimit të lartë: Universiteti/Akademia _____

I. TË DHËNA MBI PROGRAMIN STUDIMEVE TË DOKTORATËS

1. Të dhëna të përgjithshme

Emërtimi i programit të studimeve të doktoratës	Doktoratë në fushën/nënfusha
Cikli i studimeve:	Cikli i tretë
Lloji i programit:	Doktoratë
Njësia bazë	xxx
Njësia kryesore	yyy
Kodi i programit:	Sipas përcaktimeve ASCAL
Studimi me kohë normale, shprehur në vite:	3 -5
Studimi kohë të zgjatur, shprehur në vite:	5
Gjuha e studimit:	

II. TË DHËNA TË DETAJUARA TË PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS

1. Përshkrim i programit të studimit

Informacion i detajuar rreth programit,

- cila është njësia/njësitë bazë/kryesore që do e ofrojë/në.
- motivimi pse duhet të hapet/riorganizohet,
- analiza e kontekstit të fushës së kërkimit shkencor,
- të argumentohet lidhja e fushave të kërkimit me nevojat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare,
- të pasqyrohen të dhënat, burimet e veçanta që ka institucioni,
- objektivat e programit,
- përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të programit,
- evidentimi i kompetencave, njohurive që doktoranti do të përfitojë deri në përfundim të programit,
- analiza SWOT e aplikimit për riorganizim / hapje programit.

2. Të dhëna mbi kriteret e pranimit në këtë program, tarifa dhe modalitete financiare:

- Kriteret e pranimit në programin.
- Kosto e studimeve të doktoratës dhe tarifa e studimit të përcaktuar me vendim të Bordit të Administrimit.
- Politika e mbështetjes financiare për doktorantët nëse ka.

3. Elementët e planit vjetor të studimeve të doktoratës bazuar në projektin kërkimor- shkencor të njësisë bazë[2]

a) Realizimi i veprimtarive të kombinuara, kur studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë, sipas kohëzgjatjes normale të studimit nga 3 deri në 5 vite, bëhet sipas planit doktoral të miratuar nga njësia bazë.

b) Realizimi i veprimtarive të kombinuara, kur studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të zgjatur, sipas kohëzgjatjes normale të studimit 5 vite, bëhet sipas planit doktoral të miratuar nga njësia bazë.

[2] Tabela mbi elementët e planit vjetor të studimeve të doktoratës do të reflektohet në ndryshimin e vendimit nr. 41/2018 të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar.

Llojet e aktiviteteve						
Formimi teorik	Pjesëmarrje në konferenca/ Workshop-e	Ndjekje dhe/ ose drejtim i praktikës mësimore ose profesionale	Konsultime/ këshillim studentësh	Përgatitje Publikime shkencore	Trajnime kualifikime të vazhduara	Shqyrtimi i literaturës
		Ndjekje dhe/ ose drejtim i praktikës mësimore ose profesionale		Përgatitje Publikime shkencore	Shqyrtimi i literaturës	Shkrimi i disertacionit
		Ndjekje dhe/ ose drejtim i praktikës mësimore ose profesionale			Përgatitje Publikime shkencore	Shkrimi i disertacionit

4. Personeli akademik për realizimin e programit
Numri total i personelit akademik të angazhuar

Nr.	Personeli akademik	Titulli akademik	Institucioni	Njësia bazë	Lloji i angazhimit (me kohë të plotë)
1					
2					
3					

5. Programet e Përbashkëta

Ky seksion plotësohet vetëm nëse programi i propozuar ofrohet në bashkëpunim me një institucion tjetër duke përfshirë edhe një përshkrim të nivelit të bashkëpunimit, duke iu përgjigjur elementëve të mëposhtëm:
- Burimet financiare dhe kontributi i partnerëve.
- Vënia në dispozicion e burimeve nga partnerët.
- Administrimi i programit.
- Lëshimi i diplomës dhe lloji (diplomë e përbashkët/e dyfishtë/e shumëfishtë).
- Të dhëna mbi aktin e themelimit/licencimit të institucionit partner në vendin e origjinës.
- Të dhëna mbi aktin e akreditimit të institucionit partner ose të programit të studimit.
- Dokument zyrtar bashkëpunimi mes palëve, marrëveshja kuadër.
- Marrëveshja specifike për programin konkret të studimit.

6. Analizë e prioriteteve të kërkimit shkencor

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- Ndryshimi dhe avantazhet potenciale të programit të propozuar për hapje në lidhje me programet e ngjashme të studimit të ofruara nga IAL të tjera.

-Koherenca e temës kërkimore me kërkesat e tregut të punës apo financuesve dhe prioritetet e zhvillimit të fushës/fushave kërkimore ne rang kombëtar apo ndërkombëtar (fushat kërkimore përcaktohen sipas përcaktimeve të kornizës ligjore në fuqi).

- Nevoja e hulumtimit, kërkimit shkencor, inovacionit, të thelluar në këtë fushë.

- Marrëveshje me institucione publike dhe jo publike të cilat mund të asistojnë kërkimin shkencor.

7. Kriteret bazë, që duhet të plotësojë kandidati përpara mbrojtjes së disertacionit

Në këtë seksion duhet të përfshihen kriteret bazë që duhet të plotësojë kandidati përpara mbrojtjes së disertacionit si më poshtë:

a) Të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, së paku 3 (tre) referime, 2 (dy) nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN;
b) të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilët 1 (një) të jetë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të rankuara në Journal Citation Reports ose Scopus, ku është, së paku, autor i dytë.
c) Kandidati harton disertacionin sipas formatit të miratuar në rregulloren e ciklit të tretë të studimeve. Disertacioni duhet të sjellë risi teorike dhe/ose empirike në fushën përkatëse të kërkimit, si dhe të jetë një kontribut në avancimin e njohurive shkencore. Disertacioni hartohet në gjuhën shqipe dhe një përmbledhje e tij (2000–4000 fjalë) në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, në format të shtypur dhe elektronik. Disertacioni miratohet nga udhëheqësi shkencor përpara dorëzimit.

III. Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit:

AMBIENTI I ZHVILLIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE I STRUKTURËS MENAXHUESE

Numri dhe sipërfaqja e auditorëve	
Laboratorët dhe mjediset profesionale për realizimin e kërkimit	
Bibliotekë fizike dhe online	
Numrin e librave	
Numrin e posteve të leximit	
Mjedise në dispozicion për doktorantët	